

SENAD NEZIRI

**NDËRRIMI I KODEVE GJUHËSORE BRENDË SHOQËRIVE
SHUMËGJUHËSHE**

Abstrakt

Me këtë punim të ndërrimit të kodeve gjuhësore, sidomos në shoqërinë multietnike në Kosovë, posaçërisht në komunat që kanë një shoqëri folëse shumëgjuhëshe, do të mundohemi t'i japim dëshmitë e të folmeve brenda këtyre zonave ku na paraqiten raste të ndryshme të ndërrimit të kodeve gjuhësore, të gjuhëve që fliten brenda asaj shoqërie ose edhe ndërrimi i kodeve gjuhësore që vjen si pasojë e personave të ardhur nga mërgata shqiptare ose edhe minoritare në Kosovë, me të cilat, në këtë rast kemi ndërrim të kodit gjuhësor me ndikim nga një gjuhë e Bashkimit Europian. Këtu do të shohim se i njëjti individ mund të shfaqë klasifikime të ndryshme të vetes në raste të ndryshme, sipas rrethit shoqëror ku ndodhet.

Fjalë kyçe: ndërrimi i kodit gjuhësor, bilinguizmi, shoqëria folëse, rrethet shoqërore, linguistika, etnolinguistika.

HYRJE

1. Qëllimi i hulumtimit. Qëllimi i hulumtimit ka qenë të verifikojmë dhe argumentojmë nivelin e procesit të ndërrimit të kodeve gjuhësore në një shoqëri shumëgjuhëshe e shumëetnike, të japim një pasqyrë të pranisë së gjuhëve amtare të komunitetit shumicë dhe komuniteteve pakicë, të japim arsyen e pranisë së procesit të ndërrimit të kodeve dhe mënyrën e përdorimit të kësaj dukurie në një shoqëri, ku shqipja është gjuhë e parë zyrtare, ndërsa gjuhë të tjera të pakicave janë gjuhë zyrtare, por të nivelit të dytë. Gjithashtu, kemi dashur të shohim se sa e shpeshtë është dukuria e ndërrimit të kodeve gjuhësore në shoqërinë shumëgjuhëshe. Përmes anketës, të cilën e kemi bërë me një pyetësor, dhe incizimeve të bisedave, kemi dashur të kuptojmë se cilët janë faktorë dhe situatat që e krijojnë një dukuri të ndërrimit të kodeve gjuhësore, si te etnia shqiptare, ashtu edhe te etnitë minoritare, dhe kjo dukuri a gjen shprehjen në familje ose në rrethana të tjera. Më tej, përmes anketës dhe incizimit, kemi dashur të identifikojmë se cili kod bën ndikim më të madh brenda një bisede ku kemi një proces të ndërrimit të kodeve, nëse e evidentojmë atëherë qëllimi ishte ta argumentojmë këtë dukuri. Gjithashtu, jemi përpjekur të kuptojmë se procesi i ndërrimit të kodeve gjuhësore është dukuri e cila është shprehje e folësve dygjuhësh ose këtë e bëjnë për qëllime të tjera. Hulumtimi nuk ka pasur për qëllim të bëjë matje të caktuara, por qëllimi ka qenë orientues.

2. Metodologjia e hulumtimit. Për ta realizuar këtë punim të ndërrimit të kodeve gjuhësore kemi bërë një hulumtim fillestar në muajin prill të vitit 2014. Ndërkaq, sa i përket metodologjisë së anketimit, kemi bërë një pyetësor në të cilin i kemi përdorur mostrat e rastit, por në disa raste, siç janë personat e identifikuar si shumëgjuhësh, njëjtë edhe familjet shumëgjuhëshe, kanë qenë grupe të synuara. Të anketuarit kanë qenë kryesisht popullsi aktive, në kuptim të angazhimit të tyre në studime dhe vendet e profesionet e tyre të punës. Janë anketuar gjithsej 120 persona, prej tyre 95 meshkuj dhe 25 femra. Hulumtimi është kryer në komunën e Prizrenit.

Në këtë hulumtim të opinionit publik, nga të anketuarit kemi marrë informata për përkatësinë etnike, gjuhën amtare, profesionin, gjininë, prejardhjen regjionale dhe vendbanimin. Të anketuarve ua kemi sqaruar se anketimi bëhet për qëllime studimore të karakterit sociolinguistik dhe që informatat e marra prej tyre do të përdoren vetëm në kuadër të këtij studimi dhe do të mbeten e drejtë e autorit të studimit, meqë e dëshmon edhe fakti që të anketuarve u është dhënë mundësia të mbeten anonimë. Gjatë hartimit të pyetësorit kemi përdorur kryesisht pyetjet me përgjigje të hapura, ku e kemi kërkuar mendimin e lirë dhe origjinal të çdo të anketuari, ndërsa pyetësorët kanë qenë të përgatitur me shkrim.

Përveç pyetësorit, kemi realizuar edhe disa incizime të bisedave ose situatave ku e kemi evidentuar procesin e ndërrimit të kodeve gjuhësore brenda një familje ose brenda një shoqërie shumëgjuhëshe e shumetnike.

Ç'është ndërrimi i kodit (code-switching)?

Ndërrimi i kodeve gjuhësore na paraqitet me ekzistimin e shoqërive shumëgjuhëshe, të cilët me kontaktet e tyre të përditshme, në vijimësi, me zhvillimin e teknologjisë dhe marrëdhënieve biznesi kanë krijuar një globalizim gjuhësor. Me globalizimin gjuhësor, si një trend në rritje në botën moderne, shumica e komuniteteve folëse në botë janë shumëgjuhëshe. Këtë dukuri kontaktuese Chung¹ e konsideron si forcë e rëndësishme të shumicës së njerëzve. Por, nuk duhet ta anashkalojmë faktin se shoqëritë shumëgjuhëshe në botë kanë ekzistuar edhe para globalizimit. Pavarësisht këtij globalizimi, ose ndoshta pjesërisht për shkak të tij, linguistët termin e ndërrimit të kodit e mbajnë përgjithësisht të njëjtë, si code-switching.²

Sipas Clyne³ (1972), ndërrimi i kodit është një ndryshim nga një gjuhë apo shumëllojshmëri gjuhësh në një gjuhë tjetër. Abalhassan-Alshalawi⁴

¹ H. H. Chung, *Code Switching as a Communicative Strategy: A Case Study of Korean-English Bilinguals*, në "Bilingual Research Journal", 30: 2, 2006, f. 293.

² Ch. Niley, "Code Switching" in *Sociocultural Linguistics Colorado Research in Linguistics*. Boulder: University of Colorado, June 2006. Vol. 19. f. 1.

³ M. Broersma; K. Bot, *Triggered codeswitching: A corpus-based evaluation of the original triggering hypothesis and a new alternative Bilingualism: Language and Cognition* 9 (1), 1-13 C, 2006, f. 1. Cambridge University Press.

ndërrimin e kodit e vërejnë në komunikimin ndërpersonal midis bilingëve. Ndërrimin e kodit në dy ose më shumë komunitete gjuhësore e përkufizon edhe Wardhaugh⁵, ku këtë ndërrim e konsideron si një shenjë solidariteti ndërmjet dy gjuhëve mike apo kolegëve në një situatë informale, ku njerëzit kanë nevojë të zgjedhin një kod të veçantë, sa herë që ata flasin dhe ata mund të vendosin për të kaluar nga një kod në kodin tjetër, ose t'i përziejnë kodet edhe gjatë shprehjeve shumë të shkurtra dhe në këtë mënyrë të krijojnë një kod të ri, i njohur si ndryshim i kodeve (code-switching). Broersma-Bot (2006:1) lehtësimin e ndërrimit të kodit nga një gjuhë në tjetrën e shohin me ndihmën e fjalëve që janë pjesë e të dy gjuhëve. Di Pietro (1977, sipas Abalhassan-Alshalawi, 2000) ndërrimin e kodit e përcakton si përdorimin e më shumë se një gjuhe nga komunikuesit në ekzekutimin e aktit të folurit. Scotton dhe Ury (1975, sipas Abalhassan-Alshalawi, 2000) përkufizojnë se ndërrimi i kodit është përdorimi i dy ose më shumë gjuhëve në të njëjtën mënyrë gjatë të folurit apo bisedës. Pastaj Peterson (1988, sipas Abalhassan-Alshalawi, 2000) pretendoi se ndërrimi i kodit mund të ndodhë në mes të dy ose më shumë kodeve, duke i përfshirë edhe dialektet. Scotton (1992, sipas Abalhassan-Alshalawi, 2000) thekson se ndërrimi i kodit është zgjedhja e formave të bilinguistit ose multilinguistit, atë të gjuhës amë, apo atë të gjuhës së shpallur a të paraqitur në atë bisedë. Pastaj Scotton-Myers⁶ (1993) pohojnë se codswitchingu dhe huamarrja janë dy procese në vazhdimësi më shumë ose më pak të ngjashme. Hudson⁷ këtë dukuri të ndërrimit të kodeve e sqaron në zëvendësimin e kodit dhe në përzierjen e kodeve, ku beson se kjo dukuri është si pasojë e pashmangshme e dygjuhësisë, që e drejton folësin për ta zgjedhur një gjuhë të cilën personi tjetër mund ta kuptojë. Shkurtaj⁸ për code-switching e përdor termin prishja e kodeve, ndërsa për cods-mixting e përdor termin përzierja e kodeve. Termi i parë, prishja e kodeve, nuk na del në përputhje me kuptimin e ndërrimit të kodeve, meqë këtu nuk krijohet një prishje, por një formim me ndihmën e një gjuhe tjetër. Ndërsa Stolz (2008: 1-42) i trajton tre terma si: ndryshimin e kodit, përzierjen e kodit dhe kalimin e kodit. Gal⁹ thotë se ndryshimi i kodit (codeswitchingu) është një strategji bisedore që përdoret për të krijuar, kaluar apo shkatërruar kufijtë e ndryshimeve në marrëdhëniet

⁴ K. Abalhassan; H. Alshalawi, *Code-switching Behavior of Arab Speakers of English as a Second Language in the United States*. Intercultural Communication Studies X: 1, 2000. f. 179.

⁵ R. Wardhaugh, *An introduction to sociolinguistics*, Blackwell Publishing, 2006, f. 101.

⁶ Sipas Th. Stolz, *Romancisation worldwide*, në "Aspect of Language Contact" – New York, 2008, f. 15.

⁷ R. Hudson, *Sociolinguistika*, Dituria, Tiranë, 2004, f. 63-67.

⁸ Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistikë e shqipes*, botimi II, Morava, Tiranë, 2009, f. 321-324.

⁹ S. Gal, *The Political Economy of Code Choice*. In Heller, 1988, f. 247.

ndërpersonale me të drejtat dhe obligimet e tyre brenda një grupi, ku për studim e merr shoqërinë shumëgjuhëshe të Singapurit. Moradi¹⁰ e shtjellon përzierjen e kodeve ku i definon si praktikë e lëvizjes në mes të variacioneve e gjuhëve në kontekste të ndryshme sociale. Kjo është, thotë ai, alternativë e dy ose më shumë gjuhëve, ose varieteteve gjuhësore në të njëjtën bisedë apo të folurit. Pagano¹¹ ndërrimin e kodit e she si të domosdoshëm gjatë bisedave të të dy bilingjë që përdorin gjuhë të ndryshme, përveç gjuhës së tyre amtare, të cilët mund të kalojnë nga një gjuhë në një tjetër, janë krijues të ndërrimit të kodit – code-switching.

1.2. Sfondi i ndërrimit të kodit gjuhësor. Ndërrimi i kodit është studiuar gjerësisht gjatë dy dekadave të fundit në kuadër të një funksioni dhe një perspektive strukturore. Ndërrimi i kodit mund të përfshijë nivelet e ndryshme të gjuhës, si: fonologjinë, morfologjinë, strukturat gramatikore ose artikuj leksikorë (Abalhasan-Alshalawi, 2000: 180). Clyne¹² si shkaktarët e code-switchingut i përkufizon: transfertat leksikore (pronë e një gjuhë standarde që është bërë pjesë e leksikut e atij që e flet gjuhën tjetër), homofone dygjuhëshe dhe emra të duhur. Për tërheqjen e vëmendjes kërkimore për këtë fenomen na paralajmëron Chung (2006: 294), Belazi-Rubin-Toribio¹³, Broersma-Bot (2006: 1), ndërsa Nilep (2006: 1) na e jep shifrën e të dhënave kërkimore duke u bazuar në çdo degë të gjuhësisë, që e arrin shifrën 1800 artikuj. Megjithatë, ka mosmarrëveshje rreth përkufizimit të ndërrimit të kodit. Disa konsiderojnë se ndërrimi i kodit i përfshin të gjitha frazat, ndërsa disa mendojnë se gjatë ndërrimit të kodit përfshihen vetëm fjalë të vetme, por që dallohen nga huamarrësit.

Pra, siç shihet, përpjekjet për studimin e dukurisë së ndërrimit të kodeve (code-switching) janë bërë përgjithësisht nga linguistët e huaj dhe kjo dukuri është studiuar për shoqëritë e ndryshme dygjuhëshe ose edhe trigjuhëshe të botës. Studimet shqiptare për këtë dukuri janë të kufizuara ose janë trajtuar në kuadër të qëllimeve të tjera të hulumtimit të ndërndikimeve të gjuhëve të Ballkanit. Në kuadër të sociolinguistikës problemin e trajton Shkurtaj (2009),

¹⁰ H. Moradi, *Structural Aspects of Persian-English Code-Mixing*. Asian Journal of Research Social Sciences and Humanities, Panjab University, Chandigarh, India Vol. 4, No. 6, June 2014, f. 119.

¹¹ A. E. Pagano, *Code-switching: a Korean case study*. Griffith Working Papers in Pragmatics and Intercultural Communication 3, 1, 2010, f. 23.

¹² M. Clyne, *Dynamics of language contact*. Cambridge: Cambridge University Press, 2003, f. 2.

¹³ H. E. Belazi; E. J. Rubin; A. J. Toribio, *Code Switching and X-Bar Theory: The Functional Head Constraint*. Linguistic Inquiry, Vol. 25, No. 2, 1994, f. 221.

Ndërrimi i kodeve gjuhësore brenda shoqërive shumëgjuhëshe

pastaj Munishi¹⁴ në kuadër të ndërndikimeve gjuhësore e prek procesin e ndërrimit të kodeve gjuhësore, B. Mustafa¹⁵ e cila e shtjellon faktorin e ndikimit të ndërrimit të kodit në Kosovë etj. Besojmë që edhe ky punim do ta ndihmojë këtë fushë.

Shembujt e kësaj natyre të ndërrimit të kodeve ose të përzierjes së kodeve në bashkësitë shumëgjuhëshe i kemi në një numër shumë të madh duke ndërndikuar njëra gjuhë në tjetrën, por posaçërisht shqipja në gjuhë të tjera.

Në vijim do t'i japim disa shembuj të ndërrimit të kodit, që janë studiuar nga gjuhëtarë të ndryshëm: Shembujt nga studimi i Shaderit (sip. Shkurta, 2009: 324):

01 A: A po bëjta sot abmachen?	A: A do të lëmë takim për sot?
02 B: Po moj, gute Idee.	B: Po moj, ide e mirë .
03 C: Ich cha nöd, se kam Theater.	C: Unë nuk mundem , se kam teatër.
04 B: Oh, kam harruar, ich gang hüt zu mim Onkel.	B: Oh, kam harruar, unë sot shkoj te xhaxhai im .
05 A: Oh mega schad, kam [Physik?]	A: Oh, tepër keq , kam [fisikë?]
06 C: Eh, hajdeni am Mäntig në Migro, ich han një Rock gseh.	C: Eh, hajdeni të hënën në Migros [supermarket], unë kam parë një fustan .
07 B: Shihemi Montag.	B: Shihemi të hënën .
08 C: Hajt, bye.	C: Hajde, bye [good bye]

Në këtë shembull Shaderi paraqet një bisedë ku ishin të pranishëm tre persona. Ndërsa tani do t'i japim disa shembuj fjalish ku kanë depërtuar huazime nga maqedonishtja dhe duket një përzierje e theksuar, që e evidenton Shkurta (2009: 328-29): Shkova në *bollnojc*, sot jam në *bollovanje*. Kam punë ke *naçallnojku* (Veleshtë-Strugë); Ni *potvërd* xhi mora pi *Mesna kancellarisë* për ta çit ni dokument pi *katastari*; Gje kesh n' *opshtinë* për ta marr ni *uverenje* xhi ta *produzzi* askerllëkun (Xhepisht-Tetovë).

Por, Shkurta i evidenton raste edhe më shumë të përziera saqë vështirë se mund të kuptohen nga bashkëkombësit shqiptarë që banojnë jashtë atyre mjediseve, p.sh.: *Shtetën* ja pagoj, *prekërshokin* s' e pagoj (Prespë); Në *utakmicën* me *protivnikun* e *povredita* kambën; Të *shutiratesha* unë, *stoposto* do të ishte gol; *Popllava* e para do muajve e ka *propost* krejt fushën (Radushë-Shkup).

Pra siç shihet ndikimi i maqedonishtes ka sjellë ndërrimin e kodit brenda bisedave në gjuhën shqipe edhe te etniteti shqiptar. Pastaj, te Shkurta (2009: 340) i hasim shembuj ku shpesh një mesazh i formuar në një kod përsëritet në tjetrin: në këto raste përsëritja shërben për të sqaruar një koncept ose për t'i

¹⁴ Sh. Munishi, *Probleme të zbatimit të dygjuhësisë shqip-serbisht në Kosovë*, Konferencë shkencore e mbajtur më 10-11 nëntor 2011 në Prishtinë nga ASHAK dhe ASHSh, Prishtinë, 2012.

¹⁵ B. Mustafa, *Factors influencing Code-Switching in Kosova*, në *Filologji* 13, FF, UP, 2005.

dhënë emfezë mesazhit: “**Caru maritu ti voglio dire... dua të them...**” Pastaj, në mjaft raste, gjithashtu, anglishtja përdoret në kontekste ku folësit citojnë fjalët e dikujt tjetër, si p.sh.: “**Kur shërbeja u, nga më thëshjën:**” Ehu, jo! **Leave this and go over there.** Siç na njofton Shkurtaj në këto raste fillimi i bisedës është në arbërisht, kurse thelbi, përkundrazi, është në gjuhën në të cilën vihet citimi. Pra shpeshësia e anglishtes, siç thotë Shkurtaj në këtë rast, është e lidhur, së fundi, me ato kontekste në të cilat biseda lidhet me zakone të jetës angleze.

2. Rezultatet dhe gjetjet e ndërrimit të kodit gjuhësor brenda shoqërisë shumëgjuhëshe

2.1. Pasqyra e përdorimit të ndërrimit të kodit. Nëse jeton në një rreth shumëgjuhësh e shumëtnik atëherë medoemos do t’i nënshtrohesh procesit të ndërrimit të kodit gjuhësor. Duke i pasur predispozitat e vendbanimit në këtë rreth shumëtnik kemi bërë një pyetësor të rastit, në të cilin, për të treguar se ekziston ndërrimi i kodit gjuhësor, kemi kërkuar deklarin e përkatësisë etnike dhe të gjuhës amtare. Aty kemi evidentuar persona me etni të ndryshme, meqë kërkesa jonë ishte që çdo qytetar të shprehet pa kurrfarë presioni në vendimin e tij, normal, as ne nuk kemi tentuar që t’i ndihmojmë askujt në dhënien e përgjigjeve, sepse, siç kemi cekur, qëllimi ynë ishte shprehja e lirë dhe gjendja reale. Në këtë aktivitet i kemi përfshirë 120 persona të cilët e kanë plotësuar pyetësorin në fjalë. Prej tyre, 92/76,66% janë deklaruar shqiptarë, 8/6,66% janë deklaruar si kosovarë dhe 1/0,83% si kosovar-shqiptar, 1/0,83% torbesh, 3/2,5% goranë, 8/6,66% boshnjakë, 4/3,33% myslimanë dhe 3/2,5 turq. Gjatë punës tonë hulumtuese kemi vërejtur se deklarimi i përkatësisë etnike, në disa raste, nuk përkon me deklarin e gjuhës amtare, pra ndodh një shpërputhje e etnisë në raport me gjuhën amtare. Nga 92 shqiptarë, 70/76,08% janë deklaruar se gjuhën amtare e kanë shqipen, 4/4,34% se gjuhën amtare e kanë boshnjakishten, 3/3,26% se gjuhën amtare e kanë turqishten, 2/2,17% se gjuhën amtare e kanë nashinishten (našinski), ndërsa 10/10,86% konsiderojnë si gjuhë amtare shqipen dhe boshnjakishten, 3/3,26% shqipen dhe turqishten.

Këtu mund të shohim se kemi shpërputhje të përkatësisë etnike me gjuhën amtare. Gjithashtu në deklarin e gjuhës amtare kemi edhe gjuhë të cilat nuk janë gjuhë zyrtare të Kosovës ose edhe të komunës së Prizrenit, por janë të folmet lokale, siç është gjuha nashinski – gjuhë e cila përdoret nga popullata joshqiptare, gjuhë e cila përkon me të folmen bulgaro-maqedonase. Ndërsa, 9 që u deklaruan si kosovarë, gjuhën amtare e konsiderojnë shqipen.

Në vijim do t’i japim pasqyrat tabelare (shih tabelën¹⁶ 4, 5, 6, 7, 8) të gjendjes së përdorimit të gjuhës në raport me etninë përkatëse, ku në

¹⁶ Nga ky version janë hequr tabelat dhe shtojca e punimit për shkak të faqeve të kufizuara për botim.

përgjithësi të anketuar ishin etnitë minoritare në Kosovë, përkatësisht në Prizren, si: boshnjakë, turq. Gjatë punës tonë hulumtuese në analizimin e pyetësorëve të plotësuar kemi hasur edhe në etni minoritare të tjera, si: goran, mysliman (edhe pse dimë se etnia kombëtare mysliman nuk ekziston në Kosovë). Prej tyre, 1 është deklaruar si torbesh, por gjuhën amtare e konsideron boshnjakishten, 3 janë deklaruar goranë dhe si gjuhë amtare e konsiderojnë goranishten, 8 janë deklaruar boshnjakë, ku 7/87,5% si gjuhë amtare e konsiderojnë boshnjakishten, ndërsa 1/12,5% gjuhën amtare e konsideron goranishten; 4 janë deklaruar mysliman dhe si gjuhë amtare e konsiderojnë boshnjakishten; 3 janë deklaruar turq dhe si gjuhë amtare e konsiderojnë turqishten.

Nga të gjitha këto pasqyrat tabelare për përdorimin e gjuhëve në raport me përkatësinë etnike, por edhe konfirmimin e tezës tonë për ndërrimin e kodeve gjuhësore e sqaron tabela vijuese e cila na jep rezultatet e ndërrimit të kodit. Në këtë tabelë shihet se ka të anketuar të cilët edhe pse deklarohen në një përkatësi etnike, si gjuhë amtare e marrin një gjuhë të përkatësisë tjetër etnike. Kjo nuk ndodh vetëm te përkatësia etnike shqiptare, por kjo ndodh edhe te përkatësitë e tjera etnike. Pra, nga këto pasqyrat e dhëna dhe nga tabela përfundimtare shihet se procesi i ndërrimit të kodeve gjuhësore krijon një domosdoshmëri dhe është proces i pashmangshëm për zonën tonë të hulumtimit. Pra, nga 120, 93/77,5% përkon përkatësia etnike dhe gjuha amtare, 14/11,66% nuk përkon përkatësia etnike me gjuhën amtare, 13/10,83% deklarohen në një etni dhe si gjuhë amtare i konsiderojnë dy gjuhë.

2.2. Arsyetimi i ndërrimit të kodeve gjuhësore. Përdorimi i gjuhës amtare dhe i ndonjë gjuhe tjetër është shkaktar i ndërrimit të kodeve gjuhësore, gjë e cila arsyetohet me praninë e etnive të tjera në lokalitete të caktuara. Nga përgjigjet e marra kemi ardhur në përfundim se procesi i ndërrimit të kodeve gjuhësore ose përdorimi i disa gjuhëve brenda një hapësire ose shoqërie, arsyetohet: me praninë në shoqëri të një personi i cili nuk e njeh gjuhën e shumicës pjesëmarrëse ose edhe të pakicës, kur personi tjetër është pjesëtar i etnitetit tjetër ose shtetas i huaj, për komunikim dhe marrëveshje sa më të mirë, për shkak të respektit ndaj dikujt dhe tolerancës, për plotësimin e kuptimeve të fjalive ku e humb shprehjen përkatëse në gjuhën amtare, për shkak të biznesit dhe klientëve, për shkak të punës së përditshme, për shkak të shprehisë, për shkak të tingëllimit më të mirë etj.

Pasi që i kemi analizuar pyetësorët e plotësuar, kemi hasur edhe në mendimet e të anketuarve lidhur me situatat dhe vendet e funksionalizimit të ndërrimit të kodit. Nga hulumtimi i bërë na dalin disa përkime me arsyen e përdorimit, por na dalin edhe vendet e situatat e funksionalizimit të procesit të ndërrimit të kodeve, të cilat janë: shoqëria multietnike, puna e përditshme, rastet e solemnitetit, rastet e zyrtaritetit, vendet turistike dhe gjatë udhëtimeve, lokalet e ndryshme (kafeteritë), në shkollë ku procesi mësimor zhvillohet në

disa gjuhë, gjatë procesit të përkthimit, në miqësi, në fqinjësi, në mërgatë, në festa të ndryshme, në seminare e trajnime të ndryshme, në bashkëshortësi etj.

2.3. Mënyra e ndërrimit të kodeve gjuhësore. Për të pasur një mostër të ndërrimeve të kodeve gjuhësore kemi bërë disa incizime me diktofon. Në këto incizime i kemi përfshirë dy bisedat e rastit. Bisedën e parë që e kemi incizuar, do ta quajmë **Biseda 1**, e incizuar në Drejtorinë e Financave, por në Zyrën e Thesarit në Prizren. Në incizim ishin të përfshirë dy personat e Zyrës së Thesarit, një palë e rastësishme dhe incizuesi. Këta personat në **Bisedën 1** i kemi shënuar si: **Personi A, Personi B, Personi C dhe Personi D. Personi A** ishte incizuesi, i cili ishte banor i fshatit Lubizhdë të Prizrenit, njohës dhe folës i dy gjuhëve, i përkatësisë etnike shqiptare dhe si gjuhë amtare e kishte shqipen. **Personi B**, ishte femër 53-55-vjeçare, zyrtare e Zyrës së Thesarit, banore e qytetit të Prizrenit, i përkiste etnisë boshnjake dhe si gjuhë amtare e konsideron gjuhën boshnjake, por paraqitet si njohëse jo e shkallës së lartë të shqipes. **Personi C**, ishte mashkull 43-45-vjeçar, zyrtar i Zyrës së Thesarit, banor i qytetit të Prizrenit, i përkiste etnisë shqiptare dhe si gjuhë amtare e konsideron gjuhën shqipe, por na paraqitet si biling i shkallës së lartë, meqë, përpos shqipes, e zotëron mirë edhe serbishten, kroatishten, ose bosnishten. **Personi D**, ishte palë e rastësishme, mashkull rreth 50-vjeçar, banor i anës së Zhupës, anë e cila në përgjithësi i përket dhe deklarohet si etni minoritare boshnjake, por kemi edhe etni shqiptare e serbe.

Personi A ishte biling dhe shihet që bisedën e zhvillon me të dy persona (B dhe C) në gjuhën e tyre, meqë **Personi B**, siç thamë, ishte biling jo i shkallës së lartë, pasi ishte folës i mirë i bosnishtes, ndërsa shqipen e përdorte vetëm për nevojat e punës së përditshme. **Personi C** ishte shqiptar biling, i cili ishte i nivelit gati të njëjtë me njohjen e gjuhës së dytë me gjuhën amtare, ndërsa **Personi D**, sa e kuptuam, ishte folës vetëm i gjuhës së tij amtare. **Personi A** nga biseda e zhvilluar, shihet se në të njëjtën kohë, duke u bazuar në praninë e dy personave me dy etnitete, i përdor të dy gjuhët, së pari njërën e pastaj tjetrën gjuhë:

A: Ne, ne došo sam vako samo nešto da pitam, danas sam predao, kt qe bine sge,....

C: Ajde drejtor.

A: S..., si je, si po kalon?

C: Mirë faleminderit! Po ju si jeni? Shtojca e punimit, Biseda 1

A (i drejtohet B-së): Toj je toj, oče da te iskoristif ama če te stajf u neku poziciju da nemožesh i sam da ilezeš.

C: U kry.

A: Faleminderit shumë, falla puno. Ajt ditën e mirë, prijatno.

Shtojca e punimit, Biseda 1

Por, edhe në të njëjtën kohë përdor të dy gjuhë:

A: Ovo je probaj jednom pa posle ajt da ne bine, za ovo sto vikaš. Tako i mene jen put, bif uradif, a ban, tha, me shku me e marr atë, neznam neki dokument. Ajt shkova, otido tamo. Ka taj mi vika: Më fal, po ky person ishte para gjysëm ore.

Shtojca e punimit, Biseda 1

A: Vidi, jedan upitnik je, jer ja som na doktorant ... vršim jenu studiju dvojezičnosti, obično sa osobe, (i drejtohet C-së) si objekt i studimit, a ke ashtu, po, - sa osobe koje koristif dva, tri ili četiri jezika. Imam jedan upitnik ... Shtojca e punimit, Biseda 1

A: Nuk kam me marr kurrqjo te ju, nemam da uzmem ništa. Shtojca, Biseda 1

Kjo mënyrë e ndërrimit të kodeve gjuhësore ndodh, meqë Personi A dëshiron të kuptohet mirë nga të dy personat, ose, në disa raste, edhe për të mos e anashkaluar Personin B, minoritet, por në përgjithësi ndërrimi i kodit vjen me ndërrimin e bisedës me Personin C.

Raste të njëjta paraqiten edhe te Personi C, i cili, siç thamë, është biling i shkallës më të lartë. Personi C si gjuhë amtare e përdor shqipen, por deklarohet se i flet edhe të folmet serbe ose kroate, por nuk e pranon faktin se e folmja boshnjake e Kosovës ka lidhje me bosnishten. Përdorimin edhe të një gjuhe tjetër, përpos shqipes, Personi C e arsyeton me vendin e punës dhe me bashkëjetesën e gjatë me etni të ndryshme minoritare. Personi C, gati njëjtë si Personi A, ndërrimin e kodit e bën varësisht prej pranisë së palëve në zyrën e tij, pra ndodh që brenda një bisede në të njëjtën kohe bisedon me dy kode, ose herë me njërin kod e herë me tjetrin kod:

A: Si e kupton ti, si e marrish ti, a e marrish si boshnjakishte apo e marrish si serbishte, ashtu si e kupton ti.

C: Na kemi mësuar në shkollë serbokroatisht, e tash unë qysh e flas. Se dallon gjuha boshnjake edhe gjuha serbe.

A: Ti shprehu qysh mendon ti. Në Kosovë serbishtja është gjuhë zyrtare e pastaj vijnë këto gjuhë të tjera minoritare në kuadër komune.

D: Selamalejkum.

C: Selamalejkum.

D: (Vjen personi i katërt) Kod koga.

C: Biraj ago kod koga ti je drago. Shtojca e punimit, Biseda 1

Personi B paraqitet si person i cili e njih gjuhën e dytë, shqipen, edhe pse si gjuhë amtare e konsideron gjuhën boshnjake. Në këtë incizim Personi B, edhe pse deklarohet se e njih shqipen, ai nuk na kontribuon në **Bisedën 1** me ndonjë frazë të shqipes, vetëm se në një rast i lexon pyetjet e pyetësorit në gjuhën shqipe. Por, shihet në Bisedën 1, se gjatë bisedës së zhvilluar në gjuhën shqipe, ndërmjet Personit A dhe Personit C, Personi B bashkëbisedon me ata

duke mos e ndërruar kahjen dhe domethënien e bisedës, pra i kupton të gjitha, por i kthen përgjigjet në gjuhën e vet:

A: *Ovo je probaj jednom pa posle ajt da ne bine, za ovo sto vikaš. Tako i mene jen put, bif uradif a ban tha me shku me e marr atë, neznam neki dokument. Ajt shkova, otido tamo. Ka taj mi vika: Më fal, po ky person ishte para gjysëm ore.*

B: *Eto vidiš. Sto puta sam mu rekla.*

A: *I u koju poziciju ja som ostao.*

C: *Edhe ma keq!*

A: *Edhe ma keq!*

C: *Shkojnë atje nanën jau shajnë, fjalosen, edhe vijnë këtu thojnë a ban me shku atje.*

A: *Po!*

B: *I onda odma misle da smo uzeli pare.* Shtojca e punimit, Biseda 1

Në Bisedën 1 na paraqitet rasti i njëjtë sikur në tabelën 11, vetëm se këtu kemi një situatë dhe vend tjetër. Duhet të cekim se të anketuarit e bisedës ishin të njoftuar për plotësimin e pyetësorit, por nuk ishin të njoftuar që biseda e cila zhvillohet gjatë plotësimit të këtij pyetësori ishte duke u incizuar. Arsyeja e vetme pse nuk i kemi njoftuar ishte, sepse kemi dëshiruar ta regjistrojmë gjendjen reale.

Mostrën e tjetër, për të dëshmuar dukurinë e ndërrimit të kodeve gjuhësore në familjet ose rrethet dygjuhëshe, e kemi incizuar në një lokal në fshatin Lubizhdë të Prizrenit, që do ta quajmë **Biseda 2**. Në këtë bisedë janë përfshirë katër persona, që do t'i emërtojmë: **Personi 1, Personi 2, Personi 3** dhe **Personi 4**. Personi 1 ishte i përkatësisë etnike shqiptare rreth 30-vjeçar, me profesion ishte teknik medicinal dhe e kemi identifikuar si biling shqip-serbisht (kroatisht, bosnisht). Personi 2 ishte i përkatësisë etnike shqiptare rreth 50-vjeçar, e kishte të përfunduar Fakultetin e Bujqësisë, gjithashtu edhe këtë e kemi identifikuar si person biling, njëjtë si Personi 1. Personi 3 ishte i përkatësisë etnike shqiptare rreth 45-vjeçar, me profesion ishte kuzhinier, edhe ky ishte biling. Personi 4 edhe ky ishte me përkatësi etnike shqiptare rreth 48-vjeçar, i cili në këtë mandat është zgjedhur kuvendar në Kuvendin e Prizrenit. Pra, siç shihet, që të gjithë personat ishin bilingë të nivelit të lartë, sepse gati në nivele të njëjta e kanë folur dhe njohur si njëren gjuhë, ashtu edhe tjetrën. Personi 3 na paraqitet si biling, por në domenet familjare përgjithësisht është folës i shqipes. Personi 1 na paraqitet si biling, njëjtë edhe në domenet familjare është duke i përdorur dy gjuhë, meqë nënën e kishte nga zona sllavishtfolëse e Zhupës. Personi 2 na paraqitet si biling, ku edhe në domenet familjare është duke i përdorur dy gjuhë, meqë nëna e tij vjen nga familja shqipfolëse, ndërsa gruaja e tij nga familja sllavishtfolëse shqiptare. Personi 4 na paraqitet si biling jashtë domeneve familjare, meqë në familje është duke e

Ndërrimi i kodeve gjuhësore brenda shoqërive shumëgjuhëshe

përdorur vetëm të folmen sllave (boshnjake), por është kuvendar i partisë shqiptare.

Nga biseda e zhvilluar ndërmjet këtyre personave shohim ndërrime të shumta të kodeve gjuhësore, si të shqipes, ashtu edhe të të folmeve sllave. Në këto raste i kemi evidentuar shembujt ku brenda një fjalie përdoren të dy gjuhë:

-2: *U Žur uzele prvo mesto za Remzi Ademaja, ali oni lom, llom i kan bo 49 ekipe kan pas*

-1: *T'shane, je dobro!*

-3: *Unë kum pyt, ti duhesh me na kallëzu neve na nuk dijmë, jo s'ki nevoj me ma sha nanën. Au, ovo je staro.*

Shtojca e punimit, Biseda 2

Pastaj kemi evidentuar se i njëjti person me personin tjetër herë flet shqip, herë boshnjakisht:

1→2:

-1: *Ama igraše taj. On ne pobedif, 4:1 ne pobedile. Ali igra, ima i brzina, ima i šut,....*

-1: *20 euru u kon ekipi bac V....*

-1: *Edhe Zhuri i madh 30 ekipe nuk o problem.*

2→1:

-2: *U Žur uzele prvo mesto za Remzi Ademaja, ali oni lom, llom i kan bo 49 ekipe kan...*

-2: *Kqyre, edhe mu njëri pom' thot mue, tha shum keq kemi kalu a. Qe ata djemt e, cili ke bre, a KAG-i, ata djem t'Arbanës.*

4→2:

-4: *V... a če peče jeno kilo, za nas za drugogo nikogo ne*

-4: *Leje ai shka o tu fol, me bo me marr nja dy kila mish*

2→4:

-2: *Shumë po kërkon, ohhh.*

Shtojca e punimit, Biseda 2

Nga Biseda 2 kemi vërejtur që e folmja e domenit familjar ka rol të rëndësishëm në ruajtjen e gjuhës amtare, meqë Personi 3 në këtë bisedë na paraqitet, në të shumtën e rasteve, si ruajtës i kodit të tij familjar, edhe pse në disa raste e përdor kodin e dytë folës. Pra, Personi 3 është shkaktar më i madh i ndërrimit të kodit gjuhësor, meqë ai përgjithësisht e përdor gjuhën shqipe dhe nga personat e tjerë identifikohet si folës më bindës i një gjuhe tjetër, edhe pse të gjithë të tjerët janë shqiptarë dhe si gjuhë amtare, përpos Personit 4, e konsiderojnë shqipen në domenet familjare, ndërsa në punë e shoqëri të ndryshme e përdorin edhe kodin e dytë.

Për të dëshmuar dukurinë e kodit gjuhësor i kemi marrë edhe shembujt tjerë. Rasti është evidentuar në një familje shqiptare, por dygjuhëshe, në Lubizhdë të Prizrenit, p.sh.:

Personazhi	Kodi i bisedës
------------	----------------

A	Arlind të lutem shko te gjyshja e ftoje për darkë!
B	Po, qe po shkoj.
C	Arlind ku po shkon?
$B \rightarrow C$	Otidna do staku da ga viknem za vecera. (shq. Shkova deri te gjyshja ta ftoj për darkë)
$A \rightarrow B$	Arlind a e thirre gjyshen?
$B \rightarrow A$	Po, e thirra.
$C \rightarrow B$	Arlind pse s'po më thirr edhe mua?
$B \rightarrow C$	Pa, nemi reklje za tebe. (shq. Po, nuk më kanë thënë për ty)

Në këtë rast, A-ja është nëna e Arlindit (i cili është B) të cilët së bashku janë shqipfolës, ndërsa C-ja është nusja e shtëpisë e cila e din shqipen, por në përgjithësi është sllavishtfolëse, pra edhe pse C-ja i drejtohet B-së me gjuhën që e përdor B-ja, prapëseprapë B-ja nuk i përgjigjet me gjuhën e tij, por me gjuhën me të cilën e ka identifikuar C-në.

3. Përfundime

Angazhimi i shoqërisë kosovare, sidomos i asaj prizrenase, dhe institucioneve qendrore e lokale, japin një shembull për përfshirjen dhe respektimin e gjuhëve të minoriteteve brenda jetës së përditshme dhe sferave të ndryshme duke e ndjekur një politikë progresive në kërkesat e standardeve të kërkuara nga Bashkimi Europian dhe nga dokumentet e ndryshme ndërkombëtare për respektimin dhe përfshirjen e gjuhëve minoritare në shoqëri të ndryshme.

Nga hulumtimi i bërë kemi konstatuar se shqipja si gjuhë e parë zyrtare në Republikën e Kosovës ka zgjuar interesim për t'u mësuar, ose edhe për t'u folur edhe nga etni të tjera minoritare, por na dalin fakte të një tradite të procesit të ndërrimit të kodeve gjuhësore për shkak të situatave dhe interesave të ndryshme jetësore. Në këtë shoqëri, në të shumtën e rasteve, duke u bazuar në shumë dukuri të përmendura brenda këtij punimi, kemi vërejtur se, në shoqërinë prizrenase paraqitet një domosdoshmëri e ndërrimit të kodit në raste dhe situata të veçanta.

Hulumtimi na ka treguar se çdo përkatësi etnike, si ajo shqiptare e cila është shumicë, si ajo boshnjake, turke etj. që janë pakicë, në përgjithësi e respektojnë gjuhën e tyre amtare, por na dalin disa raste, të cilat mund të dallohen brenda këtij punimi, kur nuk konsiderohet si gjuhë amtare ajo gjuhë e përkatësisë etnike, por ndonjë gjuhë e ndonjë etniteti tjetër ose përveç gjuhës së etnitetit të caktuar si gjuhë amtare konsiderohet edhe një gjuhë e dytë. Edhe pse nga përkatësitë e minoriteteve kemi marrë mendime paraprake se ata nuk e përdorin ndonjë gjuhë tjetër përpos gjuhës së tyre, punimi na e tregon të kundërtën, sidomos për shqipen e cila medoemos kërkon një përdorim për qëllime të ndryshme, rast i cili krijon një domosdoshmëri të dygjuhësisë ose edhe të ndërrimit të kodit.